

Titulli :Konsultim Publik “Mbi Planin Social Vendor,Bashkia Shijak.”

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet në ambjentet “Tek qendra Multifunkionale, Shijak” në datë 27/09/2024, ora 09:00.

Pjesëmarrës:

- **Nga ana e Bashkisë:** Këshilltarët e Këshillit Bashkiak, Zv.Kryetar i Bashkisë, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik,Keshilltare e Kryetarit,Pergj.Sek.Ndihmes Ekonomike,Administratorët Shoqerore te Njësive Administrative,Punonjesit e Qendres Komunitare Shijak.
- **Nga komuniteti:** Banorët e Bashkisë Shijak,ZVA-Shijak,anëtarët e shoqërisë civile, gjimnazet, mësuesit, grupe te ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.

Zv.Kryetare Shpresa Domi:Pershendetje te gjithëve!

Ju falenderoj per pjesemarrjen ne kete konsultim publik.

I jap fjalen Pergj.Sek.Ndihmes Ekonomike te na japi nje permbledhje mbi kete Draft Plan i cili ju eshte vene ne dispozicion.

Atalanta Balliu (Pergj.Sek.Ndihmes Ekonomike):Pershendetje !

PLANI SOCIAL VENDOR TË BASHKISË SHIJAK PËR VITIN 2024-2027

Bashkia Shijak përbëhet nga 4 njësi administrative: Shijak, Gjepalaj, Maminas dhe Xhafzotaj. Bashkëpunimi midis ASHK dhe çdo Bashkie në këtë proces do të realizohet nëpërmjet Marrëveshjes përkatëse TIP bashkëlidhur këtij relacioni .

Plani Social Vendor në Bashkinë Shijak ka për qëllim të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh për grupet në nevojë përmes ndërtimit të një strategjie bashkëpunimi midis enteve te ndryshme, duke përfshirë institucionet lokale dhe rajonale, organizatat vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe bizneset lokale, me synimin e përmirësimit të shërbimeve sociale. Përmes planifikimit dhe implementimit të veprimeve të përshtatshme, synohet të zvogëlohet dhe lehtësohet varfëria në Bashkinë Shijak, përmirësuar shërbimet për familjet, fëmijët dhe individët e varfër dhe ata të përfshirë në varfëri ekstreme. Synimi është të krijojë një mjedis më të mirë për personat me aftësi të kufizuara, duke integruar sistemin e pagesave në shërbimet e përfshira, me qëllim të inkurajimit të integritetit të tyre në shoqëri dhe ekonomi. Qëllimi përfshin sigurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me standarde për të gjitha grupet në nevojë në territorin e Bashkisë Shijak, duke përdorur fuqizimin, riorganizimin dhe koordinimin e shërbimeve sociale

Plani synon të paraqesë një vizion afatgjatë dhe një rrugë të qartë drejt mbrojtjes sociale për këtë bashki deri në vitin 2027. Ai (plani) është produkti i konsultimeve të thelluara dhe diskutimeve me profesionistë, ekspertë dhe aktorë të fushës së mbrojtjes sociale. Plani përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë dhe ofron një kornizë monitorimi për të siguruar respektimin e standardeve të cilat do të garantojnë një cilësi më të mirë të jetës për njerëzit në nevojë. Gjithashtu metodologjia është bazuar të metoda e vlerësimit me pjesëmarrje, përmes kombinimit të intervistave me aktorët përgjegjës dhe profesionisteve të fushave të: shërbimeve sociale, shëndetësore, arsimit, punësimit dhe formimit profesional, sigurisë publike, etj. me mbledhjen e të dhënave statistikore dhe informacionit të disponueshëm në nivel lokal.

Përveç kësaj, procesi me pjesëmarrjen e punonjësve të bashkisë bëri të mundur që nëpërmjet takimeve dhe fokus grupeve me specialistë të sektorëve përkatës (shërbime sociale dhe buxhetit-financës) të merreshin të dhëna specifike mbi shërbimet që ofron Bashkia Shijak. Gjithashtu u zhvilluan konsultime edhe me përfaqësues të Institucioneve lokale dhe nje organizate, e cila vepron në territorin e bashkisë, me fokus ofrimin e shërbimeve sociale për target grupe të ndryshme. Në mënyrë të hollësishme, përgatitja e Planit ndoqi hapat si më poshtë:

- Një vështrim i plotë i politikave vendore lidhur me shpërndarjen e shërbimeve sociale;
- Një inventar i shërbimeve të ofruara nga organizata dhe shoqata që ofrojnë shërbime sociale në Bashkinë e Shijakut;
- Identifikimi i grupeve të mundshme në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.
- Identifikimin e gjendjes aktuale të tipave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar mbi shportën e shërbimeve.
- Identifikimin e roleve të strukturave ekzistues dhe njësisve të nevojshme për bashkëpunim për hartimin e Planit të ri Social Vendor, dhe monitorimit të tij në vazhdimësi. Konsultime me strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve sociale;
- Konsultime me strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vendor ;
- Konsultim me përfaqësues të organizatave që ofrojnë shërbime për komunitetin.

Metodologjia është hartuar duke marrë në konsideratë Bashkinë e Shijakut si njësi më vete me specifikat e nevojave për shërbime sociale, si dhe me specifikat për zhvillimin e shërbimeve në të ardhmen. Metodologjia ka parashikuar gjithashtu mbledhjen e të dhënave sasiore (aty ku disponohen) për secilin target grup dhe shërbimet sociale që ofrohen.

Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Shijak do të garantojë shërbime të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë në bashkëpunim me OJQ-të dhe sektorin privat për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të të rriturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

Misioni i Bashkisë Shijak është të angazhohet në mënyrë aktive në krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi ku çdo individ dhe familje të ndihet e mbrojtur dhe e përkujdesur. Bashkia do të punojë për të siguruar shërbime të integruara dhe efikase për individët në nevojë. Synon të ndërtojë një mjedis ku zhvillimi personal dhe ekonomik i të gjithë banorëve është i inkurajuar dhe i mbështetur.

3. Parimet e Planit Social Vendor

Plani Social Vendor, Bashkia Shijak, synon të sigurojë një përfshirje të gjerë dhe të barabartë të të gjithë grupeve dhe individëve të disavantazhuar, duke respektuar të drejtat e të njeriut dhe duke adresuar sfidat sociale si varfëria, pabarazia, dhe mungesa e aksesit në shërbime të nevojshme. Disa nga parimet dhe hapat që përfshihen në këtë plan janë:

Përfshirja sociale: Sigurimi i një mundësie të barabartë për të gjithë në shërbime dhe mundësi pa bërë dallime duke përfshirë të gjithë individët dhe familjet.

Respektimi i të drejtave të njeriut: Bazuar në dinjitetin e individëve, kemi për qëllim garantimin e jetës dhe përfshirjen e tyre në shoqëri.

Bashkëpunimi dhe partneriteti: Për të arritur objektivat specifike ndërtohen partneritete me organizata jo-qeveritare, sektorin privat dhe aktorët shoqërorë.

Trajtimi i varfërisë dhe pabarazisë: Kujdesi ndaj sfidave të varfërisë dhe pabarazisë, duke ofruar ndihmë dhe mbështetje për grupet që ndjehen më të prekura.

Zhvillimi i qëndrueshëm: Përparimi drejt një zhvillimi shoqëror të qëndrueshëm, duke marrë parasysh mirëqenien afatgjatë të familjeve dhe individëve, duke u përpjekur për të krijuar një mjedis që respekton dhe ruan vlerat dhe burimet shoqërore për brezat e ardhshëm.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale: Ruajtja e të dhënave personale të individëve, duke respektuar plotësisht dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Qeverisja e mirë: Sigurimi i transparencës, pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe një llogaridhënie të plotë në proceset vendimmarrëse, duke krijuar një ambient të hapur dhe të drejtë, ku çdo qytetar ndihet pjesë e procesit dhe ka besim në përgjegjshmërinë e qeverisjes lokale.

Universaliteti dhe mosdiskriminimi: Garancia e aksesit të barabartë për të gjithë dhe puna për të eliminuar çdo formë të diskriminimit, duke siguruar një mjedis ku secili individ ndihet i respektuar dhe i barabartë pavarësisht ndryshimeve dhe dallimeve.

Hapat specifike të veçantë për të realizuar këto parime përfshijnë:

- Financimi i Fondit Social për shërbime sociale.
- Burime financiare (Përpjekje për identifikimin dhe mobilizimin e burimeve financiare në mënyrë të qëndrueshme, duke përfshirë mekanizma të ndryshëm për mbështetjen e projekteve dhe shërbimeve sociale.)
- Hartimi dhe zbatimi i politikave lokale të mbështetura në respektimin e të drejtave të njeriut, të fëmijëve dhe barazisë gjinore.
- Sigurimi i aksesit të barabartë tek shërbimet e decentralizuara.
- Ndërtimi i shërbimeve sociale të përshtatura në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive financiare.

- Implementimi i politikave që inkurajojnë pjesëmarrjen e grupeve të interesit dhe monitorimin e zbatimit të planit.

Pyetje dhe diskutime :

Anduana Shahini (Gjimnazi 16-shtatori):

- 1.Kush jane shtresat qe perfitojne nga ky plan?
- 2.Per sa kohe do te miratohet Plani?
- 3.Nga kush do te financohet Plani?

Atalanta Balliu (Pergj.Sek.Ndihmes Ekonomike)

Shtresat qe do te perfitojne jane:

- Mosha e trete
- Femijet e braktisur
- Grate e dhunuara

Manjola Celiku (Drejtoresha e Qendres Komunitare Shijak)

- 1.Bashkia do te hape nje zyre te posacme per zbatimin e ketij Plani?
- 2.Personat me aftesi te kufizuar a do te perfshihen ne kete Plan ?
- 3.Nga ky Plan do te perfshihen edhe njesite e tjera ?

Shpresa Domi (ZV.Kryetare,Bashkia Shijak)

Po do te kete nje plan te detajuar mbi perfshirjen ne sektore te ndryshem ne lidhje me punesimin.

Alesia Tahiri:

- 1.Kush jane institucionet qe na mbeshtesin ?
- 2.Do te jete dhe perfshirja me fjetje per moshat e treta ?

Atalanta Balliu (Pergj.Sek.Ndihmes Ekonomike)

Mosha e trete do te jete e organizuar qe tu sherbehet vakti kryesor.

SEKRETARI I KËSHILLIT
PUBLIK



Kozeta Doda



KOORDINATOR PER KONSULTIMIN

Fabiana Keci





31	Albert	Norja	hogoped	0683 647470	albertnorja@gmail.com
32					
33					
35					
36					
37					
38					
39					
40					



LISTE PREZENÇE KONSULTIM PUBLIK

NR	EMER	MBIEMER	POZICIONI	NR.CEL	EMAIL
1	Xhulja	Kusti	Sp. mbrojtjen + Empe	0698936153	xhulja.kusti@hotmail.com
2	Merita	Kodro	Adm. shpërndarje	0666848785	merita.kodro@yahoo.com
3	Silvana	Mouly	Sp. Këmbëse Cymuar	0692312461	silvanamerly@yahoo.com
4	Ledia	Galla	Specjalist PAT	0695551859	ledi.sultani@gmail.com
5	Anduana	Shakura	Psuqese	0694452695	krinduana@yahoo.it
6	Ambro	Osmani	Nxënëse	0697307675	Ambro.osmani@gmail.com
7	Hurme	Hishi	Nxënëse	0685487885	HurmeHishi2027@gmail.com
8	Boro	Nderrjaku	Nxënëse	0693047677	BoroNderrjaku@gmail.com
9	Jorida	Colliku	Nxënëse	0683889638	JoridaColliku@gmail.com
10	Armela	Tuda	Nxënëse	0676770535	tudaarmela@gmail.com
11	Evi	Osmani	Nxënëse	0695737116	EviOsmani@gmail.com
12	Emma	Sleri	Nxënëse	0693106540	
13	Lea	Shehu	Nxënëse	0682265043	LeaShehu@gmail.com
14	Alesia	Tahiri	Nxënëse	0693349668	TahiriAlesia1010@gmail.com
15	Maribela	Cela	Nxënëse	0682782168	maribelacela1@gmail.com
16	Anila	Keci	Nxënëse	0680126614	keciamiba@gmail.com
17	Kleida	Martani	Nxënëse	0697264079	martanikleida@gmail.com
18	Elda	Kadisi	Nxënëse	0683689080	eldakadisi123@gmail.com
20	Vaso	Proko	Nxënëse	0693118064	VasoProko@gmail.com
21	Fabiana	Kuci	Adm. shpërndarje	0683421462	fabiana.kuci@gmail.com
22	Anisa	Nderrjaku	Adm. shpërndarje	0676471572	Anisa93@hotmail.com
23	Atalante	Balliu	P. Sek Nd - Pro	0697703368	atalanteballiu@outlook.com
24	Mehmet	Celiku	P. Sociale	06743392162	celiku.mehmet78@gmail.com
25	Xhesika	Kokë	Keshilltore bryt.	0696882101	xhesika.koke@gmail.com
26	Daniela	Becculli	KV.DHF Banka shqipe	0674850665	becculldaniela@gmail.com
27	Shpresa	Domi			
28	Orca	Peçulli	Psitologe	0699836876	kollekatorca@gmail.com
29	Rexhina	Magellari	Fizioterapist	0699662967	rexhina.colomi96@yahoo.com
30	Blertha	Laci	Runonjese Sociale	0698474299	blerthahuctilaci@gmail.com